



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja Nr. 01
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 22 dhjetor 2014, në orën 13:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftiu, Time Kadrijaj, Adem Hoxha dhe Shukrije Bytyçi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

RENDI I DITËS

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Konstituimi i Komisionit.**

Kryetarja, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

Kryetarja **Flora Brovina**, pasi i përshëndeti të gjithë, duke iu dëshiruar punë të mbarë në këtë mandat, tha se Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, është një shembull i mirë i bashkëpunimit pa dallime partiake. Shfrytëzoj rastin t'i përshëndes dhe t'i falënderojë ish-kryetarin e Komisionit, z. Damka dhe ish-nënkryetaren, znj. Kadrijaj për angazhimin dhe punën që kanë bërë si udhëheqës të komisionit, e të cilët janë sërish në këtë komision. Besoj se do të jenë bashkëpunëtorë shumë të ngushtë edhe do të me ndihmojnë që në atë frymë të bashkëpunimit ta udhëheq edhe unë së bashku me dy nënkryetarët e këtij komisioni.

Është kënaqësi të punosh në këtë komision sa do që detyrat e komisionit janë shumë të vështira, është një ndër komisionet e veçanta, që mbulon dy ministri më problematike në Qeveri, ku janë grumbulluar problemet e shumta.

Pra, kjo mbledhje më tepër është e karakterit konstituiv, njohjes ndërmjet veti, e në veçanti të njihemi me anëtarët e rinj të komisionit. Besoj shumë se do të kemi një bashkëpunim të mirë ndërmjet veti pa dallime partiake. Pa një bashkëpunim të ndërsjellë nuk do të ketë sukses as komisioni, me vjen mirë që në mesin tonë kemi anëtarë të profesionit, të cilët i njohin mirë këto çështje dhe së bashku do t'ia dallim, theksoi Brovina.

Flora Brovina, pasi mori fjalën, tha se unë jam për të pestën herë radhas deputete e Kuvendit të Kosovës. Vetëm herën e parë nuk kame qenë pjesë e Komisionit të Shëndetësisë, pasi që në legjislaturën e parë kanë qenë të ndarë shëndetësia dhe çështjet sociale, mirëpo, kam qenë nënkryetare e komisionit për mirëqenie sociale, kurse herëve të tjera, kam qenë pjesë e këtij komisioni, andaj konsideroj që jam njohëse e mirë e problematikës si në aspektin shëndetësor ashtu edhe atë të çështjeve sociale. Me profesion jam mjeke pediatre tha Brovina dhe kërkoi një prezantim të shkurtër të anëtarëve të tjerë të komisionit

Njomza Emini: “ Fillimisht me lejoni t’ ju përshëndes dhe t’ ju uroj sukses. Ky është mandati im i dytë si deputete e Kuvendit të Kosovës. Me profesion jam sociologe, njëherësh edhe politikologe. Zotohem para jush dhe jam e gatshme atë që e di, si nga përvoja akademike dhe përvoja parlamentare nuk do të kursehem të kontribuojë për këto çështje. Konsideroj se edhe ju e dini se ka shumë nevojë në përmirësimin e gjendjes, sidomos në sektorin e shëndetësisë por edhe në çështjet sociale. Shpresoj shumë se bashkëpunimi ndërmjet nesh s’do të mungojë po ashtu edhe sukseset...”

Fikrim Damka tha se edhe unë personalisht ju përshëndes dhe ju uroje suksese dhe punë të mbarë të gjithëve në këtë Komision. Në mandatin e kaluar unë e kam udhëhequr këtë komision dhe kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë. Në mandatin e kaluar disa ligje shumë të rëndësishme i kemi aprovuar, të cilat janë buxhetuar sivjet. Unë konsideroj se këto ligje duhet të monitorohen, sidomos Ligji për Sigurimet Shëndetësore, po ashtu edhe Ligji për Shëndetësinë. Ne akoma s’e kemi pranuar programin legjislativ, mirëpo, besoj shumë se do të kemi punë në Ligjin e Punës për ndryshimin dhe plotësimin e tij dhe besoj se kontributi im nuk do të mungojë në punën e këtij komisioni, theksoi Damka.

Time Kadrijaj pasi përshëndeti deputetët e rinj tha se të gjithë jemi të vetëdijshëm se na pret një punë e vështirë, pasi që të gjithë e dimë se në çfarë gjendje është shëndetësia dhe çështjet sociale. Besoj se do të gjejmë një bashkëpunim dhe do t’ia dalim së bashku, pasi që çështjet madhore nuk donë politike dhe nuk janë partiake por na përkasin të gjithëve. Besoj se do të punojmë bashkërisht në mbikëqyrjen e ligjeve, që janë të rëndësishme së veçantë, në mënyrë që me rekomandimet tona edhe qeveria të reflektojë në evitimin e mangësive që identifikohen. Edhe unë besoj se do të kemi një bashkëpunim të mirë dhe suksesi nuk do të mungojë. Me profesion jam mjeke gjinekologe. Kam punuar në menaxhimin dhe inspektimin shëndetësor dhe e njoh mirë gjendjen në sistemin shëndetësor, tha znj. Kadrijaj.

Fadil Beka tha se jam i privilegjuar, fillimisht se jam zgjedhur për herë të parë deputet i Kuvendit të Kosovës, po ashtu ndihem i privilegjuar se jam edhe anëtar i këtij komisioni. Me profesion jam kirurg dhe punoj në QKUK. Po ashtu edhe unë kam një përvojë menaxheriale në institucionet shëndetësore dhe e njoh mirë gjendjen që mbretëron në shëndetësi. Në këtë komision po ndihem mirë me kolegët dhe me angazhimin dhe punën e përbashkët do të mundohemi që të arrijmë rezultate të mira, si në sektorin e shëndetësisë po ashtu edhe në atë të çështjes sociale, pasi që këta dy sektorë janë gjendje shumë të vështirë, theksoi Beka.

Besa Baftiu tha se edhe unë fillimisht ju përshëndes të gjithëve dhe ju uroj sukses. Edhe unë jam për herë të parë deputete e Kuvendit të Kosovës, mirëpo edhe mua ajo që më bëri përshtypje është se të gjithë folësit para meje ishin apartiakë dhe të gjithë u betuan se do të punojnë për të mirën e shëndetit. Shëndeti dhe mirëqenia sociale e qytetarëve nuk është në gjendje të mirë dhe besoj se të gjithë bashkërisht brenda mundësive tona do të angazhohemi në përmirësimin e këtyre dy sektorëve mjaftë të rëndësishëm për jetën e qytetarëve. Me profesion jam neonatologe pediatre. Nuk kam ndonjë përvojë menaxheriale në sektorin e shëndetësisë pasi që kam punuar vetëm në profesionin tim në Spitalin Rajonal të Gjilanit dhe njëkohësisht në Spitalin Amerikan, mirëpo gjendjen se çfarë mbretëron si në sektorin e shëndetësisë dhe atë të mirëqenies sociale e njoh mirë andaj edhe unë do të jap kontributin tim maksimal dhe do të bashkëpunojë ngushtë me të gjithë juve në të mirë të shëndetit dhe mirëqenies sociale të qytetarëve të Kosovës, theksoi Baftiu.

Adem Hoxha tha se edhe unë fillimisht ju përshëndes të gjithëve dhe ju uroj sukses dhe punë të mbarë gjatë këtij mandati, po ashtu edhe unë betohem se do të jap kontributin tim dhe do të bashkëpunojë me të gjithë juve në këtë Komision me qëllim të përmirësimit të gjendjes në sektorin e shëndetësisë dhe atë të mirëqenies sociale.

Hatim Baxhaku pasi mori fjalën tha se edhe unë fillimisht ju përshëndes dhe ju uroj suksese të gjithëve. Me profesion jam kirurg. Kam qenë kryeshef i Departamentit për kirurgji në Spitalin Rajonal të Prizrenit, prej ku kam dhënë dorëheqje me rastin e zgjedhjes sime si deputet i Kuvendit të Kosovës, me qëllim të përkushtimit dhe angazhimit si deputet. Edhe unë besoj shumë se bashkërisht do t'ia dalim që ti përmbushim objektivat e kërkuara që ka komisioni.

Shukrije Bytyçi pasi i përshëndeti dhe i uroj sukses të gjithë anëtarëve të komisionit tha se se me profesion është kimiste dhe se ndjehet e privilegjuar që për herë të parë është deputete e Kuvendit të Kosovës. Edhe unë tha Bytyçi zotohem se angazhimi dhe munda ynë nuk do të mungojë dhe shpresoj shumë se bashkërisht do t'ia dalim në përmbushjen e obligimeve tona që i kemi para vetes si komision.

Kryetarja Flora Brovina pasi mori sërish fjalën falënderoi të gjithë për betimin e dhënë dhe deklarin gjatë punës duke theksuar se do të kenë një bashkëpunim të mirë në punën që i pret. Unë me sa vërejta, shtoi ajo, anëtarët e komisionit me shumë qenkan mjek se sa njohës të çështjeve sociale, por besoj se shumë shpejt do të hymë edhe në botën e problemeve dhe të çështjeve sociale. Bashkërisht do të punojmë me qëllim të përmirësimit të gjendjes në këta dy sektorë mjaftë të rëndësishëm për jetën e qytetarëve tanë.

Atëherë edhe njëherë me lejoni që t'ju falënderojë për praninë tuaj dhe gatishmërinë për bashkëpunim në punën tonë që na pret. Mund të ndodhë që të kemi edhe një takim urgjent të komisionit për shqyrtimin e Projekt Buxhetit, nëse jo, atëherë do të takohemi dhe do të fillojmë me përgatitjen e planit të punës së komisionit për vitin 2015, përfundoi Flora Brovina.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përqatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA